



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## **RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Agnese Ibrahim</b>	<b>03.11.2023</b>	<b>16.11.2023</b>	<b>2023/0846</b>

### **BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 28.10.2023, OE “MEDIATECH & PRINT SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0846, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “DataProgNet SH.P.K.”- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt” me nr. të prokurimit: "656-23-9797-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 13/09/2023

Hapja e ofertave: 25/09/2023

Vendimi i AK-së: 16/10/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0846 i dt:28.10.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### **DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE**

Neni 1 Qellimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-

Diskriminimi; Neni 11 Informatat Sekrete Afariste; Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve; Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës; Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese;

Më datën **16.10.2023**, Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ** në Platformën e E-Prokurimit ka bërë publikimin e Formularit - **B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues-për dhënie te kontratës, ku me kontratë ka shpërblyer Operatorin Ekonomik DataProgNet SHPK**

Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ** -ja në formularin-letrën standarde për eliminim, ka shënuar :

#### ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Pas Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të dërguar me datë ku si AK kemi kërkuar nëse OE e posedon Certifikatën e Menaxhimit të Sh ISO IEC 20000-1 2018, mirpo OE nuk ka ofruar dëshmi se e posedon Certifikatën kërkuar sipas Dosjes së Tenderit.

Në arsyetimin për eliminimin të **Operatorit Ekonomik MEDIATECH&PRINT SHPK**, shihet shumë qartë se Autoriteti Kontraktues-**KOMUNA FERIZAJ** -Komisioni vlerësues pra antaret e komisionit nuk kane vepruar konform ligjit te LPP-se duke na eliminuar pa drejtesisht nga ky aktivitet i prokurimit pasiqe arsyetimi per eliminim te kompanise sone eshte shume i ulet dhe nuk qendron ajo arsye e eliminimit.

Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të **Nenit 59, të LPP-së**

**dhe Nenit 41 të RROUPP-A01**, pasi që vlerësimin e ofertave nuk e ka bërë duke u bazuar në gjendjen faktike dhe dëshmime të cilat i ka pasur te prezantuara në ofertën tonë.

Autoriteti Kontraktues **KOMUNA FERIZAJ** ka bërë shkelje të **Nenit 60 të LPP-së**, pasi që nuk na ka shpallur fitues ne si OE me cmimin me te ulet dhe i pergjegjshem ashtu siq eshte cekur ne Dosjen e tenderit :

#### **IV.6 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS**

Kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

Tenderin e përgjegjshëm, me cmimin më të ulët.

**AK-ja ketu ka bere shkelje ligjore duke vendosur te ipet kontrata OE me te shtrejt keshu duke keqperdore paran publike dhe fondet publike.**

Autoriteti Kontraktues ne vendimin e dates 16.10.2023 e ka theksuar si arsyetim te eliminimit te Kompanise sone qe ne si OE nuk kemi derguar ISO IEC 20000 – 1 2018 , ne ju informojme se ju vete AK-ja me daten 22.09.2023 keni bere ndryshimin me formularin B54 formulari per permiresimin e gabimeve dhe ne kete formular nuk ka figuruar fare kjo iso e kerkuar dhe gjate kerkeses sone per sqarim te derguar me date 26.09.2023 ne kemi kerkuar informata shtese qe te korrigjoni dosjen e tenderit perseri dhe ti vendosni kriteret e njejta si ne Formular ashtu edhe ne dosje , sepse ne baze te LPP-se Formulari B54 per permiresimin e gabimeve eshte final dhe aty qka ceken kriteret ashtu duhet te dorezohen nga OE sepse sipas ligjit ky formular eshte final sepse aty behen te gjitha ndyrshimet te dosjes se tenderit.

Ju kete veprim e keni bere me qellim dhe tendence per te shperblyer me kontrate nje OE i cili eshte i afert me ju dhe vjen nga Ferizaji dhe ne kete menyre keni lene variante ne mes formularit dhe dosjes se tenderit dhe ju e dini mire qe sipas ligjit nuk lejohen variantet dhe kjo forme e vleresimit qe keni bere .Dhe ne te njejten kohe nuk na keni kthyer pergjigjje kur kemi kerkuar te definoni qarte se cilat kriter mbesin ne dosje sepse ju ndryshe keni vendosur kriteret ne dosje dhe ndrryshe keni publikuar ne Formularin B54 Formulari per permiresimin e gabimeve ( vete kjo fjale tregon per te permiresuar dhe te lerni finale kriteret te cilat i kerkon AK-ja) .

Ka qene e arsyeshme nga ana juaj te shpallni fitues kete OE te favorizuar nga ju per arsyje se ky eshte me nje cmim shume me te larte se kompania jone per 12,053.00€ pra ne kete rast ju jeni duke demtuar buxhetin e shtetit duke keqperdorur paran publike .

Gjithashtu ne me date 16.10.2023 kemi kerkuar qasje ne dokumenta per ti shikuar gjithe dokumentacionin e ketije OE Fitues te shpallur nga ju , ne kemi ardhur ne

qasje me date 17.10.2023 por kemi hasur ne shume pa rregullesi sepse neve nuk na u eshte lejuar marrja e tere dokumentacionit te ketije OE FITUES ne baze te ligjit ne fuqi . Zyrtari nga AK na ka ofruar nje dokument “Kerkesa per sekret afarist” te perpiluar nga OE Fituese por dokumentat te cilat ky OE i ka etiketuar si sekret afarist nuk qendrojnë dhe nuk jane konform Ligjit te LPP-se sepse sekrete afariste duhen te jene 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se , pra nuk mund te jene sekret afarist nje ISO STANDARD , nuk mund te jete nje sekret afarist stafi i kompanise , dhe nuk mund te jene sekrete afariste projektet e realizuara sepse gjitha keto dokumente jane te hapura dhe publike per palen e tret te interesit sepse keto mjaftte lehte me nje kerkim te thjesht mund te verifikohen . Kete OE Fitues e ka bere me qellim apo me tendence sepse ne tani nuk jemi te sigurt a ka qene ky OE me te vertet i pergjegjshem kur nuk argumenton dhe dokumenton keto dokumente por ky me qellim kerkon ti fsheh keto dokumente te cilat nuk jane sekrete afariste per palet me interes .

#### **7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:**

Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si “sekret afarist”, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij

OE Fitues kete pike nuk e ka permbushur sepse nuk ka dhene arsyetime per secilin dokument te identifikuar si sekret afarist , por i njejt ka jep nje sqarim qesharak qe publikimi i ketyre dokumentave demton presigjin e kompanise , ky i nderuar AK eshte arsyetim qesharak dhe shume i ulet nga ky OE sepse shikone me larte siq potencohet qe nese OE deshiron te etiketoje si sekret afarsit duhet te jepe arsyetime per secilin dokument

Kerkojme nga eksperti shqyrtues dhe paneli qe ti kerkohen keto dokumenta te keti Operatori Ekonomik qe ti prezantoj dhe ju te beni verifikimin e ketyre dokumenteve se a jane origjinale apo fiktive sepse ne po mendojme qe OE dhe Ak kete e kane bere me qellim qe ti mshefin keto dokumenta nga verifikimi , ku dihet se nje ISO standard dhe kontrata e nenshkruara dhe lista e punetoreve nuk jane dokumente kofendiciale dhe jane dokumenta publike dhe te njejtat eshte dashur qe te na prezantohen.

Pra nga e gjithë kjo qe e potencuam me larte theksojme se ne pergjithesi qe nga fillimi i ketije aktiviteti AK-ja ka

leshuar gabime skandaloze dhe nuk eshte respektuar Ligji i Prokurimit Publik .

Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara me lartë dhe dëshmitë e bashkangjitura

<p><b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b></p> <p><b>Menaxheri i projektit-Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës me telekomunikacion ose master</b></p>	<p><i><u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u></i></p> <p><b><u>Menaxheri i projektit-Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës me telekomunikacion ose master, Një inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës me telekomunikacion ose master, të argumentuar me diplomë universitare dhe kontrate te punes valide ose marreveshje mbi angazhim. Menaxheri i projektit - te deshmohet me nje vendim te nenshkruar dhe vulosur nga OE dhe te nenshkruar edhe nga menagjieri ( ne original).</u></b></p>
<p><b>OE duhet të ketë së paku dy hadruersit për mirëmbajtje e paisjeve të TI-së</b></p>	<p><b>Diploma univerzitare kopje te vertetuara ne origjinal per inxhinerin kompjuterike ose shkenca kompjuterike dhe kontrata te punes valide ose marreveshje mbi angazhim.</b></p>
<p><b>Kompania duhet të sjell Certifikatën valide të menaxhimit të shërbimeve në TI ISO IEC 20000-1 2018</b></p>	<p><b>Certifikatat te noterizaur ne origjinal valide</b></p>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--





**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**ZYRA E PROKURIMIT**  
**KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE**  
**PROCUREMENT OFFICE**

Tel.: 038/200 46039  
 e-mail: [prokurimi.ferizaj@rks-gov.net](mailto:prokurimi.ferizaj@rks-gov.net)  
 Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	20.10.2023
NR/BR.	01-315/2023
PËR/ZA/TO	<b>MEDIATECH &amp; PRINT SH.P.K</b>
PËRMES	Kryetarit të Komunës z. Agim Aliu
NGA/OD/FROM	Zyra e prokurimit z. Arbërie Bektashi _____
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Vendim!

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Ferizajt, në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **19.10.2023**, nga Operatori Ekonomik: **MEDIATECH & PRINT SH.P.K.**, me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt, me nr 656-23-9797-1-2-1**, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** kërkesa per rishqyrtim e OE : **MEDIATECH & PRINT SH.P.K** e dates 16.08.2023 per tenderin me titull: **Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt, me nr 656-23-9797-1-2-1**

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesë për ri-shqyrtim janë të pabazuara. : **MEDIATECH & PRINT SH.P.K** me datën 19.10.2023 i pa kënaqur ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit **Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt, me nr 656-23-9797-1-2-1** duke supozuar se jane shkelur disa dispozita e Neneve të LPP-së. Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku konstaton si në vijim:

Ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se nuk kemi bere asnje shkelje te LPP-se  
 Sa i perkete pretendimit eliminimit tuaj ato pika qendrojnë pasi qe ju nuk keni arritur ti përmbushni kriteret ne baze te DT.Permiresimi i gabimeve ne baze te formularit B54 behete vetm ne ato pika ku behen ndryshimet ndërsa kriteret tjera mbesin te njëjta ciq edhe ka ndodhur ne kete raste, ju si baze eshte dashur te merrni parasysh dosien e tenderit. Sa i perkete asaje qe ju keni kërkuar sqarime shtese

ju ato sqarime i keni kërkuar pase afatit te fundit per sqarime dhe ne ate kerkese ju keni kërkuar informata shtese per stafin profesional dhe asnjëherë nuk keni kërkuar nje gje te tille siq edhe pretendoni.

Qasja ne dokumente ju eshte ofruar konforme ligjeve ne fuqi, pasi qe OE i rekomanduar per kontrate ka plotësuar formularin per sekrete afariste dhe nje gje e teille eshte ruajtur edhe nga ne.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, ankuesi mund të paraqes në çdo rast, një ankese pranë OSHP-së .

Ferizaj, 20.10.2023

Menaxheri i Prokurimit \_\_\_\_\_

1x1 kopje – OE Ankues

1x1 kopje – Autoritetit Kontraktues

**INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK**

n/a

**VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP**

**VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME**

n/a

**ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME**

n/a

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **MEDIATECH & PRINT SH.P.K.****

**Pretendimi 1**

OE ankues pretendon që: *“Autoriteti Kontraktues ne vendimin e dates 16.10.2023 e ka theksuar si arsye te eliminimit te Kompanise sone qe ne si OE nuk kemi derguar ISO IEC 20000 – 1 2018 , ne ju informojme se ju vete AK-ja me daten 22.09.2023 keni bere ndryshimin me formularin B54 formulari per permiresimin e gabimeve dhe ne kete formular nuk ka figuruar fare kjo iso e kerkuar dhe gjate kerkeses sone per sqarim te derguar me date 26.09.2023 ne kemi kerkuar informata shtese qe te korrigjoni dosjen e tenderit perseri dhe ti vendosni kriteret e njejta si ne Formular ashtu edhe ne dosje , sepse ne baze te LPP-se Formulari B54 per permiresimin e gabimeve eshte final dhe aty qka ceken kriteret ashtu duhet te dorezohen nga OE sepse sipas ligjit ky formular eshte final sepse aty behen te gjitha ndryshimet te dosjes se tenderit.”*

Eksperti shqyrtues sqaron se AK, me datën 21/09/2023 ka publikuar formularin *B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara*, përmes të cilit ka bërë disa ndryshime, ndër të tjera duke larguar nga kriteret teknike dhe profesionale, dy nga certifikatat për ISO standarde, të kërkuara përmes Njoftimit për kontratë, të publikuar më 13/09/2023. Në këtë formular të gabimeve të korrigjuara janë përfshirë përmirësime vetëm për ato kriteret të cilat janë ndryshuar apo larguar tërësisht si kriteret për aktivitetin e prokurimit, ndërsa pjesa tjetër e cila nuk është përfshirë në formularin e korrigjimeve, mbetet e njëjtë si në Njoftimin e parë për Kontratë. OE ankues pretendon që është eliminuar padrejtësisht për faktin që nuk ka dorëzuar me ofertë certifikatën ISO IEC 20000-1 2018, për shkak se e njëjta nuk është përfshirë në formularin e korrigjimeve të gabimeve në njoftimin për kontratë. Eksperti pasqyron që një kërkesë e tillë për ISO standard, ka qenë e përfshirë edhe në Njoftimin e parë për kontratë edhe tek kriteret në Dosje të Tenderit, përderisa kjo kërkesë përmes Formularit B54 as nuk është larguar dhe as nuk është ndryshuar, e njëjta nuk është përfshirë fare në njoftimin e dytë, që do të thotë që vazhdon të mbetet e njëjtë si në njoftimin e parë. Për më tepër, kur kjo ka qenë një kërkesë e Dosjes së Tenderit është më se e qartë që është dashur të merrej parasysh nga ana e OE ankues. AK sipas nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues që të dëshmoj posedimin e certifikatës ISO IEC 20000-2018, por OE ankues edhe pas kësaj kërkesë nuk e ka ofruar të njëjtën. Andaj arsyetimi i OE ankues se është eliminuar padrejtësisht është i pabazuar.

## **Pretendimi 2**

*“Gjithashtu ne me date 16.10.2023 kemi kerkuar qasje ne dokumenta per ti shikuar gjithe dokumentacionin e ketije OE Fitues te shpallur nga ju, ne kemi ardhur ne qasje me date 17.10.2023 por kemi hasur ne shume pa rregullesi sepse neve nuk na u eshte lejuar marrja e tere dokumentacionit te ketije OE FITUES ne baze te ligjit ne fuqi. Zyrtari nga AK na ka ofruar nje dokument “Kerkesa per sekret afarist” te perpiluar nga OE Fituese por dokumentat te cilat ky OE i ka etiketuar si sekret afarist nuk qendrojnë dhe nuk jane konform Ligjit te LPP-se sepse sekrete afariste duhen te jene 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se , pra nuk mund te jene sekret afarist nje ISO STANDARD , nuk mund te jete nje sekret afarist stafi i kompanise , dhe nuk mund te jene sekrete afariste projektet e realizuara sepse gjitha keto dokumente jane te hapura dhe publike per palen e tret te interesit sepse keto mjaftë lehte me nje kerkim te thjesht mund te verifikohen . Kete OE Fitues e ka bere me qellim apo me tendence sepse ne tani nuk jemi te sigurt a ka qene ky OE*



*me te vertet i pergjegjshem kur nuk argumenton dhe dokumenton keto dokumente por ky me qellim kerkon ti fsheh keto dokumente te cilat nuk jane sekrete afariste per palet me interes.”*

OE ankues pas kërkesës së bërë për të pasur qasje në ofertën e OE i rekomanduar, ka marr përgjigje nga AK se OE i rekomanduar ka plotësuar Aneksin 3 përmes të cilit, të gjitha dokumentet e ofertës, përfshirë Dokumentacionin e kërkuar, Stafin e Kompanisë dhe Projektet e realizuara me vlera, është kërkuar që të qëndrojnë sekret afarist dhe të mos shpërndahen tek palët e treta. Përkatësisht, sipas Ankesi 3, e tërë oferta e OE i rekomanduar është kërkuar që të mbetet sekret afarist.

Sipas ekspertit shqyrtues jo të gjitha dokumentet në një ofertë mund të cilësohen si sekret afarist, sipas nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, ky nen thotë që AK duhet të përgatitë një version të pastruar, përmes të cilit AK duhet të bëjë ndarje se cilat të dhëna mund të konsiderohen si sekrete afariste dhe cilat jo. Duke u bazuar edhe në nenin 7 të Rregullores për Prokurimin Publik, përkatësisht pika 7.6, b thotë se: Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë **duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si “sekret afarist”**, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. Po ashtu neni 7 i RRPP-së, pika 7.3 po ashtu thotë se: **Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuar nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.** Pra, sipas Legjislacionit në fuqi, dokumentet të cilat deklarohen si sekrete afariste nga ana e Operatorëve Ekonomik, të njëjtat cilësohen të tilla vetëm pasi të jenë të pranuar si sekrete afariste edhe nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Nga kjo çfarë u sqarua më lartë, eksperti vlerëson që AK duhet të krijoj një version të pastruar të dokumenteve, sekret afarist duhet të mbesin të gjitha ato dokumente apo të dhëna për të cilat edhe vet AK është bindur se me të vërtetë, shpërndarja e tyre tek operatorët e tjerë, mund të shkaktojnë çfardo dëmi për OE i rekomanduar, por sekret nuk mund të cilësohet secili dokument i ofertës dhe secila e dhënë. AK, duhet të lejoj OE ankues të ketë qasje në dokumentet përkatëse, ashtu siç e lejon edhe ligji në fuqi. Andaj, nga kjo çfarë u sqarua më lartë, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

---

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**MEDIATECH & PRINT SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt**” me numër të prokurimit: “**656-23-9797-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**MEDIATECH & PRINT SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi me printer per Komunen e Ferizajt**” me numër të prokurimit: “**656-23-9797-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **MEDIATECH & PRINT SH.P.K.**

**Agnese Ibrahimi**

